

**REKOMANDIMI NR. 13  
I POLITIKAVE TË PËRGJITHSHME TË  
ECRI-T**

**PËR  
LUFTËN KUNDËR ANTI-CIGANIZMIT  
DHE DISKRIMINIMIN KUNDËR ROMËVE**

**MIRATUAR MË 24 QERSHOR 2011**

Strasbourg, shtator 2011



Botuar nga:  
Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)  
Këshilli i Evropës - 2011  
Printuar në Strasburg

## **Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI):**

Duke pasur parasysh Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Duke pasur parasysh Rekomandimin CM/Rec(2009)4 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për arsimimin e Romëve dhe Endacakëve në Evropë (miratuar më 17 qershor 2009);

Duke pasur parasysh Rekomandimin CM/Rec(2008)5 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për politikën e romëve dhe/ose endacakëve në Evropë (miratuar më 20 shkurt 2008);

Duke pasur parasysh Rekomandimin Rec(2006)10 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për akses më të mirë në kujdesin shëndetësor për romët dhe endacakët në Evropë (miratuar më 12 korrik 2006);

Duke pasur parasysh Rekomandimin Rec(2005)4 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për përmirësimin e kushteve të strehimit për romët dhe endacakët në Evropë (miratuar më 23 shkurt 2005);

Duke pasur parasysh Rekomandimin Rec(2004)14 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për përmirësimin dhe strehimin e endacakëve në Evropë (miratuar më 1 dhjetor 2004);

Duke pasur parasysh Rekomandimin Rec(2001)17 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për përmirësimin e situatës ekonomike dhe të punësimit të romëve dhe endacakëve në Evropë (miratuar më 27 nëntor 2001);

Duke iu referuar punës së Komitetit të Ekspertëve për Romët dhe Endacakët (MG-S-ROM);

Duke marrë parasysh punën e Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale;

Duke iu referuar punës së Komitetit Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

Duke kujtuar Rekomandimit nr. 3 të Politikave të Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër racizmit dhe intolerancës kundër romëve/ciganëve, me synim ndihmën e shteteve anëtare për të marrë veprime efektive kundër diskriminimit të vuajtur prej tyre;

Duke kujtuar Rekomandimin nr. 10 të Politikave të Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor në edukimin arsimor dhe nëpërmjet tij, dhe Rekomandimin nr. 11 të Politikave të Përgjithshme të tij për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor në policim;

Duke theksuar se në raportet e tij për vendet, ECRI ka rekomanduar në mënyrë të rregullt për shumë vite se shtetet anëtare marrin masa për të luftuar paragjykimin, diskriminim, dhunën dhe përjashtimin social të vuajtur nga romët dhe i japin identitetit të romëve një shans të vërtetë të vijimësisë së ekzistencës së tyre;

Duke theksuar se për shumë vite Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka zhvilluar jurisprudencën e saj lidhur me diskriminimin që vuajë romët në fusha të ndryshme, dhe i ka konsideruar ata si të disavantazuar dhe pakicë të cenushme, duke kërkuar kështu një vëmendje të posaçme;

Duke theksuar se anti-ciganizmi është një formë specifike e racizmit, një ideologji e themeluar në superioritetin racor, një formë dehumanizimi dhe racizmi institucional i ushqyer nga diskriminimi historik, i cili shprehet, ndërmjet të tjerash, nëpërmjet dhunës, fjalimeve të urrejtjes, shfrytëzimit, stigmatizimit dhe formave më të egra të diskriminimit;

Duke theksuar se anti-ciganizmi është një formë posaçërisht e vazhdueshme, e përsëritur e zakonit e racizmit dhe i bindur për nevojën për të luftuar këtë fenomen në çdo nivel dhe me të gjitha mjetet;

Duke kujtuar se diskriminimi kundër romëve bazohet kryesisht në origjinën etnike dhe në mënyrën e tyre të të jetuarit;

Të shqetësuar thellë nga aktet në rritje të dhunës të kryera kundër një numri të madh romësh dhe pandëshkueshmërisë shumë të shpeshtë për keqbërësit;

Duke kujtuar se ruajtja e identitetit të dallueshëm të disa komuniteteve romë, me të cilët janë të lidhur anëtarët e tyre, sfidohet si nga zhvillimi ekonomik dhe nga përpjekjet e dështuara për integrim;

Duke vënë re se për shumë qytetarë romë të Bashkimit Evropian, ushtrimi i të drejtave të tyre për të lëvizur lirisht pengohet nga pengesa administrative dhe se ata janë viktimat e intolerancës dhe të praktikave abuzive;

Duke njohur se, gjithsesi, shumë shtete anëtare kanë miratuar politika të synuara, në njërin anë, të përmirësojnë situatën e romëve në fusha të tilla si arsimit, punësimi, strehimi, shëndetësia dhe kultura, dhe në anën tjetër, në luftën kundër diskriminimit që ata kalojnë, duke njohur kështu ekzistencën e dëshirës politike me të cilët përballen romët;

Duke qenë të mendimit se autoritetet lokale dhe rajonale kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në luftën kundër anti-ciganizmit;

Të ndërgjegjshëm për më tepër për iniciativat e shumta të ndërmarra nga Këshilli i Evropës, duke përfshirë dhe iniciativat e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, të OSBE-së dhe të Bashkimit Evropian për përmirësimin e jetëve të romëve dhe duke mbajtur shënim rezultatet e nxjerra nga këto iniciativa;

Duke vënë re se, pavarësisht nga gjithçka, situata e romëve në pjesën më të madhe të shteteve anëtare mbetet alarmuese dhe se shenjat e anti-ciganizmit janë gjithnjë e më tepër në rritje dhe në përkeqësim;

Duke vënë re me shqetësim se diskutimi politik në shumë shtete anëtare ka tendencë të stigmatizojë romët dhe të përforcojë urrejtjen ndërmjet tyre;

Duke kujtuar me ankth se opinioni publik në shumë shtete anëtare mbetet ende haptazi armiqësor ndaj romëve;

Duke vënë re me shqetësim që disa media e përçojnë me negativizëm imazhin e romëve;

Duke theksuar se për të qenë efektiv, veprimet për të luftuar anti-ciganizmin kërkojnë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;

Duke qenë të mendimi se masat për të ndihmuar ruajtjen e identitetit të romëve përbëjnë një ndër instrumentet kryesore për të luftuar anti-ciganizmin;

Të ndërgjegjshëm që çdo politikë e synuar për përmirësimin e situatës së romëve kërkon jo vetëm një investim afatgjatë, por edhe një vullnet politik dhe vetëpërfshirjen e romëve, si dhe përfshirjen e shoqërisë civile në përgjithësi;

Duke theksuar se është e domosdoshme për komunitetin rom të kuptojë rolin që ai duhet të luajë vetë në luftën kundër anti-ciganizmit;

Duke kujtuar se Evropa nxjerr nga historia e saj detyrën e kujtimit, vigjilencës dhe rezistencës ndaj ngritjes së fenomeneve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës;

Duke kujtuar se lufta kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës është pjesë përbërëse e mbrojtjes dhe nxitjes së të drejtave njerëzore universale dhe të pandashme, që përfaqëson të drejtat e çdo individi pa asnjë lloj diskriminimi;

Dhe duke vëzhguar po ashtu se paragjykimi i vazhdueshëm kundër romëve çon në diskriminim kundër tyre në shumë fusha të jetës sociale dhe ekonomike, dhe se ato japin energji të mjaftueshme për procesin e përjashtimit social që prekin romët;

dhe,  
duke theksuar se, në rekomandimet aktuale, termi "romë" përfshin jo vetëm romët, por edhe sintit, kalit, ashkalinjtë,

egjiptianët, monushët, dhe grupe të tilla të ngjashme popullsisë, së bashku me endacakët, në mënyrë që të përfaqohet diversiteti i madh i grupeve në fjalë;

u rekomandon qeverive të shteteve anëtare:

1. **të ratifikojnë Protokollin nr. 12 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, nëse nuk i kanë ratifikuar ende ato;**
2. **të përdorin, sipas një plani kombëtar, një qasje gjithëpërfshirëse shumëdisiplinare për çështjet që kanë të bëjnë me romët, duke përfshirë përfaqësuesit e tyre në konceptimin, inkuadrimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave të lidhura me ta;**
3. **të nxisin besim të ndërsjellë ndërmjet romëve dhe organeve publike, në veçanti duke i trajnuar ndërmjetësuesit, ndërmjet të tjerësh, dhe nga komuniteti rom;**
4. **të luftojnë anti-ciganizmin në fushën e arsimit dhe përkatësisht:**
  - a. t'i japin zbatim të Rekomandimit nr. 10 të Politikave të Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër racizmit dhe diskriminim racor rëndësi të madhe në arsimin shkollor dhe duke i trajtuar ato nëpërmjet arsimit shkollor;
  - b. të marrin masa për parandalimin dhe luftën kundër stereotipeve, paragjykitimit dhe diskriminimit të vuajtur nga fëmijët romë në shkollë, duke i bërë të ndërgjegjshëm prindërit e fëmijëve jo romë për ta, dhe duke trajnuar stafin mësimdhënës, në veçanti për arsimin ndërkulturor;
  - c. të përfshijnë mësimdhënien për gjenocidin e romëve ("Parrajmos") në programet shkollore;
  - d. të marrin masa urgjente, duke përfshirë dhe masa ligjore dhe politike, për t'i dhënë fund ndarjes në shkollë, objekt i të cili janë fëmijët rom, dhe t'i integrojnë ata në shkollat e ndjekura nga nxënësit nga pjesa më e madhe e popullsisë;
  - e. të heqin çuarjen e shpeshtë të fëmijëve rom në shkolla të posaçme, duke u siguruar se nxënësit rom që nuk janë të prekur nga çrregullime mendore të mos jenë objekt i këtyre lëvizjeve dhe që fëmijët që ndryshojnë shkollë të regjistrohen pa humbur kohë në shkollat e zakonshme;
  - f. të luftojnë, nëpërmjet sanksioneve, ngacmimin e fëmijëve rom në shkollë;
  - g. të marrin të gjitha masat e nevojshme për të luftuar mungesat në shkollë dhe braktisjen e shkollës nga fëmijët rom;
  - h. të kryejnë veprime të synuara për të rritur ndërgjegjësimin e fëmijëve romë për rëndësinë e parashkollimit, të parandalimit të braktisjes së shkollave dhe të dhënit të përparësisë për arsimin e fëmijëve;
  - i. të eliminojnë çdo pengesë financiare dhe administrative për aksesin e fëmijëve rom në shkollë;

- j. të sigurojnë që çdo fëmijë rom ka akses real në kopshte;
- k. të rekrutojnë ndërmjetësues shkollash, duke përfshirë dhe ndërmjetësues romë, për të siguruar lidhje ndërmjet shkollës dhe prindërve romë;
- l. të sigurojnë se një numër i madh romësh bashkohen në profesionin e mësimdhënies, për të ndihmuar integrimin e fëmijëve rom në shkollë;
- m. t'u ofrojnë nxënësve romë në nevojë, udhëzim përgatitor dhe shtesë në gjuhën/gjuhët e tyre zyrtare;
- n. t'u ofrojnë nxënësve romë udhëzime në gjuhën e tyre, me kërkesë të prindërve;
- o. të marrin masa për sigurimin e shkollimit të vazhdueshëm për fëmijët nga komunitetet endacake;
- p. të lehtësojnë aksesin e të nxënësve gjatë të gjithë jetës për të rriturit romë që e dëshirojnë atë;
- q. të sigurojnë që tekstet shkollore nuk përmbajnë stereotipe të romëve dhe nuk përmbajnë informacion rreth gjuhës së romëve, kulturës dhe historisë së tyre dhe që paraqesin përfitimet që i kanë sjellë shoqërisë romët;
- r. të sigurojnë që rastet e diskriminimit kundër romëve në fushën e arsimit ndiqen dhe ndëshkohen;

**5. të luftojnë anti-ciganizmin në punësim, dhe përkatësisht:**

- a. të sigurojnë që legjislacioni kombëtar ofron mbrojtjen e duhur kundër diskriminimit në punësim dhe se ai zbatohet vërtetë;
- b. për këtë qëllim, të ofrojnë trajtim të përshtatshëm për nëpunësit civilë;
- c. të marrin masa pozitive për romët në lidhje me punësimin, lidhur veçanërisht me rekrutimin, ose me trajtimin profesional;
- d. të nxisin punësimin e romëve në të gjithë nivelet e sektorit publik;
- e. të marrin masa për heqjen e diskriminimit kundër romëve lidhur me punësimin dhe zhvillimin e karrierës;
- f. të ndihmojnë romët që vuajnë nga diskriminimi për t'u punësuar për të siguruar të drejtat e tyre para organeve civile ose administrative;
- g. të kryejnë fushata informimi dhe ndërgjegjësimi për sektorët privatë dhe publikë në mënyrë që t'i informojnë ata për legjislacionin përkatës dhe për të përmirësuar zbatimin lidhur me romët;
- h. të heqin çdo pengesë, duke përfshirë dhe ato burokratike, për ushtrimin e tregtive tradicionale;
- i. në konsultim me romët, të gjejnë alternativa për tregtitë e zhdukura, me të cilat ata janë marrë tradicionalisht, për shembull, duke ju ofruar atyre hua tradicionale për të hapur bizneset e tyre dhe/ose për të propozuar përfitime tatimore;
- j. të sigurojnë ndjekjen dhe dënimin e rasteve të diskriminimit kundër romëve;

**6. të luftojnë anti-ciganizmin në lidhje me strehimin dhe të drejtën për respektimin e shtëpisë së tyre, dhe përkatësisht:**

- a. t'u ofrojnë mundësi romëve të kenë strehim të denjë;
- b. të luftojnë ndarjen *de facto*, ose të detyruar lidhur me strehimin;
- c. të sigurojnë se ofrimi i shtëpive sociale për romët u vjen në ndihmë integritit të tyre dhe të mos i mbajë ata të ndarë;
- d. të sigurojnë që romët nuk dëbohen pa njoftim paraprak dhe pa iu dhënë atyre mundësinë e një strehimi tjetër me kushte të denja;
- e. të marrin hapa për të legalizuar zaptimin e trojeve ose banesave të romëve që kanë shkelur rregullat e planifikimit urban, pasi situata është toleruar për një periudhë të gjatë kohe nga organet publike;
- f. të nxisin bashkëjetesën dhe të kuptuarin e ndërsjellë ndërmjet personave me kultura të ndryshme në lagje në të cilat jetojnë popullsitë rome dhe jo rome;
- g. të luftojnë paragjykimet dhe stereotipet për romët dhe endacakët në lidhje me përdorimin e strehimit;
- h. të luftojnë çdo akt diskriminimi kundër romëve në lidhje me strehimin, në veçanti duke u siguruar se legjislacioni, duke përfshirë dhe legjislacionin e antidiskriminimit, zbatohet siç duhet;
- i. të marrin masa efektive kundër refuzimit për të futur romët në regjistrin e nënshtetasve, në rastet kur ata dëshirojnë të qëndrojnë në mënyrë të përhershme ose të përkohshme;
- j. të sigurojnë që rregullat e planifikimit hapësinor nuk e pengojnë sistematikisht jetën tradicionale të endacakëve;
- k. të sigurojnë zona të përshtatshme kampimi, qoftë të përhershme ose të përkohshme, për endacakët, në numra të mjaftueshëm dhe në zona të përshtatshme dhe me shërbimet e duhura;
- l. të inkurajojnë konsultimin ndërmjet të gjithë aktorëve lokalë dhe endacakëve rreth pozicionimit të zonave të kampimit të destinuara për ta;
- m. të sigurojnë se aktet e diskriminimit kundër romëve në lidhje me strehimin ndiqen dhe dënohen;

**7. të luftojnë anti-ciganizmin në kujdesin shëndetësor, dhe për përkatësisht:**

- a. të marrin masa për të siguruar akses të barabartë për kujdes të përgjithshëm cilësor shëndetësor për romët;
- b. të rekrutojnë ndërmjetës shëndetësor, në veçanti ndërmjetës që vijnë nga komuniteti rom, për të ofruar ndërlidhje ndërmjet stafit shëndetësor, menaxherëve dhe romëve;
- c. të marrin masa pozitive për të siguruar se nuk ka pengesa financiare ose administrative për romët për të përfituar kujdes shëndetësor dhe trajtim mjekësor;

- d. të ofrojnë trajnim për punonjësit shëndetësor, me synimin e luftimit të stereotipeve, paragjykitimit dhe diskriminimit kundër romëve;
- e. të sigurojnë që aktet e diskriminimit kundër romëve në sektorin shëndetësor ndiqen dhe dënohen;
- f. të ndalojnë shprehimisht çdo praktikë të stilizimit të detyruar të grave rome;
- g. të parandalojnë dhe të luftojnë çdo ndarje në spitale, dhe në veçanti në pavionet e maternitetit;

**8. të luftojnë dhunën racore dhe krimet kundër romëve, dhe përkatësisht:**

- a. t'i kushtojnë vëmendje zbatimit të Rekomandimit nr. 11 për Politikën e Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor në policim, në veçanti Kreut III të tij lidhur me rolin e policisë në luftën kundër veprave racore dhe ndjekjen e incidenteve raciste;
- b. të krijojnë një sistem gjithëpërfshirës për regjistrimin e akteve të dhunës kundër romëve;
- c. të marrin hapa për të inkurajuar viktimat rome të dhunës racore dhe të krimeve të bëjnë ankime, në veçanti duke i bërë ata të ndërgjegjshëm për organet përkatëse dhe duke i siguruar që nëse del e nevojshme ata përfitojnë të gjithë ndihmën e nevojshme;
- d. t'i ofrojnë policisë, organeve të prokurorisë dhe gjyqtarëve trajtim të posaçëm lidhur me legjislacionin që i dënon krimet raciste dhe zbatimin e tij lidhur me viktimat rome;
- e. të sigurojnë që policia dhe organet e prokurorisë kryejnë hetimet e nevojshme për krimet për shkak të racës dhe akteve të dhunës së ushtruara kundër romëve, në mënyrë që autorët e krimeve të mos mbeten të padënuar;

**9. të luftojnë manifestimet e anti-ciganizmit që kanë të ngjarë të shkaktohen nga policia dhe përkatësisht:**

- a. t'i kushtojnë vëmendje të veçantë zbatimit të Rekomandimit nr. 11 të ECRI-t për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit në policim;
- b. t'i inkurajojnë romët, të cilët janë viktimat e sjelljeve të pahijshme nga policia, të bëjnë ankesa, duke u ofruar atyre ndihmën e nevojshme;
- c. të sigurojnë kryerjen e hetimeve kur ka pretendime për sjelljen e pahijshme të policisë ndaj romëve dhe të sigurojnë që keqbërësit ndiqen dhe dënohen;
- d. të trajtojnë policinë për të drejtat e njeriut dhe legjislacionin përkatës, në veçanti për të përmirësuar të dhënat e tyre me komunitetet rome;
- e. të rrisin ndërgjegjësimin e policisë për problemet me të cilat përballen romët dhe t'i trajtojnë ata rreth problemeve që i prekin romët, dhunën dhe krimet racore, në mënyrë që të parandalohen dhe të luftohen më mirë këto fenomene;
- f. të marrin masa për të nxitur rekrutimin e romëve në forcat e policisë duke kryer, për këtë qëllim, fushata informimi në komunitetet rome;



- g. të sigurojnë që romët gëzojnë mundësi të barabarta për zhvillimin e karrierës brenda policisë;
- h. të rekrutojnë dhe të trajnojnë numra të mjaftueshëm ndërmjetësuesish për popullsinë rome, në mënyrë që të sigurojnë një lidhje ndërmjet romëve dhe policisë;
- i. të sigurojnë, në përputhje me paragrafin 10 të Rekomandimit nr. 11 të politikave të përgjithshme të ECRI-t, krijimin e një organi të pavarur për hetimin e ankesave të bëra kundër policisë, në veçanti kundër romëve;

**10. të luftojnë anti-ciganizmin e shprehur në media, ndërkohë që njohin parimin e pavarësisë së tyre editoriale, dhe përkatësisht:**

- a. të sigurojnë zbatimin e legjislacionit për ato media që e nxisin diskriminimin, urrejtjen ose dhunën kundër romëve;
- b. të inkurajojnë median të mos përmendë origjinën etnike të një personi të përmendur në artikuj dhe në raporte, kur origjina nuk është e nevojshme për të kuptuar më mirë ngjarjet;
- c. të inkurajojnë median të miratojë një kod sjellje për parandalimin, ndër të tjera, e çdo dhënie informacioni që transmeton paragjykim ose mund të nxisë diskriminim, urrejtje ose dhunë kundër romëve;
- d. të inkurajojnë median të tërhiqet nga transmetimi i një informacioni që ka të ngjarë të nxisë diskriminimin dhe intolerancën kundër romëve;
- e. të mbështesin të gjitha iniciativat e marra për të eliminuar rreziqet e anti-ciganizmit mbi profesionistët e medias dhe organizatave të tyre;
- f. të inkurajojnë organet profesionale të medias të ofrojnë trajnim specifik për gazetarët për çështjet e lidhura me romët dhe me anti-ciganizmin;
- g. të nxisin pjesëmarrjen e romëve në sektorin e medias në përgjithësi, duke marrë hapa për rekrutimin dhe trajnimin e gazetarëve dhe prezantuesve ndërmjet komuniteteve rome;

**11. të luftojnë anti-ciganizmin lidhur me aksesin në vendet e hapura për publikun dhe përkatësisht:**

- a. të sigurojnë zbatimin e legjislacionit për antidiskriminimin ndaj pronarëve, ose personave që janë përgjegjës për një vend të hapur ndaj publikut, ku mohohet hyrja e romëve;
- b. të marrin masa për inkurajimin e firmave private të sigurimit të rrisin ndërgjegjësimin e stafit të tyre dhe të trajnojnë stafin në mënyrë që të shmangët qëndrimi dhe sjellja diskriminuese ndaj romëve;

**12. të luftojnë anti-ciganizmin lidhur me aksesin në shërbimet publike dhe përkatësisht:**

- a. të sigurojnë që romët kanë akses në shërbimet e mirëqenies sociale mbi bazën e të njëjtave kushte si dhe pjesa tjetër e popullsisë dhe të zbatojnë siç duhet legjislacionin kundër diskriminimit;
- b. të sigurojnë që komunitetet rome të përqendruara në lagje ose fshatra të caktuara nuk janë të disavantazuar në marrjen e shërbimeve publike, të tilla si furnizimi me ujë, kanalizime, energji elektrike, hedhje e mbetjeve, transporti, aksesin në sistemin rrugor dhe në mirëmbajtjen e rrugëve;

- c. t'i ofrojnë trajnim nëpunësve civilë për parandalimin e racizmit dhe diskriminimit kundër romëve dhe zbatimin e legjislacionit përkatës;
  - d. të inkurajojnë romët të bëjnë ankesa në rastet kur e konsiderojnë veten viktimë të diskriminimit nga nëpunësit civilë;
  - e. të ndjekin dhe të dënojnë nëpunësit civilë që diskriminojnë romët;
  - f. të sigurojnë që romët gëzojnë të njëjtin lloj dhe cilësi shërbimesh si dhe pjesa tjetër e popullsisë;
- 13. të luftojnë anti-ciganizmin gjatë marrjes së mallrave dhe shërbimeve, në veçanti në sektorët bankarë ose të sigurisë;**
- 14. në mënyrë që të matin më mirë problemet me qëllimin e luftimit të tyre në mënyrë më efektive dhe për të miratuar politikën që do të ndërmerren, të mbledhin të dhëna statistikore për romët, në veçanti në fushat e arsimit, punësimit, strehimit dhe shëndetit, duke siguruar respektimin e parimeve të konfidencialitetit, vetëidentifikimit vullnetar dhe pëlqimit të informuar;**
- 15. të dënojnë të gjithë diskutimin publik, i cili nxit publikisht diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, urrejtjen ose dhunën kundër romëve;**
- 16. të inkurajojnë një sistem monitorimi të shprehjeve të anti-ciganizmit në Internet dhe të sigurojnë ndjekje efektive, duke ndjekur parimet e përcaktuara në Protokollin Shtesë të Konventës për krimin kibernetik, lidhur me kriminalizimin e akteve me natyrë racore dhe ksenofobie të kryer nëpërmjet sistemeve kompjuterike dhe zbatimit të tyre;**
- 17. në përgjithësi, në mënyrë që të luftohet anti-ciganizmi dhe diskriminimi kundër romëve, të sigurojnë:**
- a. që emri i përdorur zyrtarisht për komunitetet e ndryshme të romëve është emri nëpërmjet të cilit komuniteti në fjalë dëshiron të identifikohet;
  - b. nxitjen dhe mbrojtjen e kulturës rome, duke forcuar njohjen më të mirë të komuniteteve rome nga popullsia, si dhe çuarjen përpara të dialogut ndërkulturor;
  - c. avancimin e grave rome dhe të të drejtave të tyre, dhe të luftojnë diskriminimin e shumëfishtë me të cilin ato hasen;
  - d. që fëmijët romë regjistrohen në lindje;
  - e. që romëve u jepen dokumente identiteti;
  - f. që legjislacioni lidhur me nënshtetësinë nuk është diskriminues për romët;
  - g. nënshtetësinë për romët për të hequr të gjitha rastet e mungesës së shtetësisë;
  - h. që legjislacioni dhe zbatimi i tij për lirinë e lëvizjes së njerëzve nuk është diskriminues për romët;
  - i. përfaqësim të përshtatshëm politik që u bën romëve të mundur që zërat e tyre të dëgjohen;

- j. përdorimin nga romët të ndihmës ligjore, në mënyrë që ata të gëzojnë të drejtat e tyre në të gjitha rastet;
- k. promovimin e sportit për aq kohë sa ai nxit respektimin e diversitetit dhe lehtëson integrimin e romëve.



